REPUBLIKA E KOSOVËS – ZYRA E PRESIDENTIT
REPUBLIC OF KOSOVO – OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVA – URED PREDSEDNIKA

Aktiviteti javor i Presidentit, 22-28 qershor 2009, Nr.4

U hodh shorti për mandatet e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese

Presidenti i Francës, Nikolas Sarkozy i shkroi letër Presidentit Fatmir Sejdiu

Presidenti Sejdiu priti piloten shqiptaro-amerikane Faruza Kallaba

Presidentët e Shqipërisë, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Kosovës po takohen në Vlorë

Rruga Durrës-Kukës-Morinë një korridor jashtëzakonisht i rëndësishëm

Lituania e përkushtuar për të ndihmuar Republikën e Kosovës

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese zotohen se do ta kryejnë punën me nder





U hodh shorti për mandatet e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Pas tërheqjes së shortit, gjyqtarë me mandate trevjeçar u zgjodhën znj. Iliriana Islami dhe znj. Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtarë me mandate 6 vjeçar, z. Enver Hasani dhe z. Kadri Kryeziu, ndërsa gjyqtarë me mandat 9 vjeçar u zgjodhën z. Ivan Çukalloviç dhe Altay Surroi.



22.06.2009. - Në një ceremoni të organizuar sot në Presidencën e Republikës së Kosovës është hedhur shorti për kohëzgjatjen e mandateve të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

President i Republikës së Kosovës, dr. Fatmir Sejdiu theksoi se ky short është i nevojshëm duke pasur parasysh rekomandimin e bërë në Propozimin Gjithë-përfshirës të Presidentit Ahtisaari që lidhet me ritmin që duhet të ketë Gjykata Kushtetuese për zgjedhjen e gjyqtarëve dhe mandatet e tyre.

Ky ritëm, vijoi Presidenti, do të fillojë me dy gjyqtarë që do zgjidhen me mandate për tre vjet, dy gjashtë vjet, dhe dy me mandat nëntë vjet.

"Kjo bëhet për arsye se në çdo tre vjet pastaj do të zgjidhen dy gjyqtarë plus, dyve që iu skadon mandati dhe nuk kanë drejt rizgjedhje dhe dy gjyqtar që do të zgjidhen me mandat nëntëvjeçar dhe kjo vazhdon pastaj në ciklin e gjithmonshëm ku një e treta e gjykatës përtërihet në çdo tre vjet", theksoi Presidenti.

Më tej, procedura e shortit për mandatet e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës filloi me tërheqjen e plikove me mandatet e tyre, sipas rendit të aprovuar më herët nga vetë gjyqtarët e që ishte sipas listës së Parlamentit të Republikës.

Pas tërheqjes së shortit, gjyqtarë me mandate trevjeçar u zgjodhën znj. Iliriana Islami dhe znj. Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtarë me mandate 6 vjeçar, z. Enver Hasani dhe z. Kadri Kryeziu, ndërsa gjyqtarë me mandat 9 vjeçar u zgjodhën z. Ivan Çukalloviç dhe Altay Surroi.

Presidenti bëri të ditur se të premten gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës do të japin betimin si dhe do të bëhet zgjedhja e kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i cili do të jetë me mandate trevjeçar. ■

Presidenti i Francës, Nikolas Sarkozy i shkroi letër Presidentit Fatmir Sejdiu

Gati një vit e gjysmë pas pavarësisë së tij, Shteti juaj ka ditur të afirmohet në skenën ndërkombëtare dhe pakthyeshmëria e ekzistimit të tij i është imponuar të gjithëve.

22.06.2009. - Presidenti i Republikës së Kosovës, dr. Fatmir Sejdiu priti ambasadoren e Francës në vendin tonë, znj. Dolphine Borione, e cila, me këtë rast, i dorëzoi Presidentit Sejdiu një letër drejtuar atij nga Presidenti i Francës, Nikolas Sarkozy. Më poshtë po e japim të plotë letrën e Presidentit Sarkozy:

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Paris, më 19 Qershor 2009

Zotëri President,

Gati një vit e gjysmë pas pavarësisë së tij, Shteti juaj ka ditur të afirmohet në skenën ndërkombëtare dhe pakthyeshmëria e ekzistimit të tij i është imponuar të gjithëve. Njohjet e fundit të vendit tuaj sikurse edhe hyrja e kohëve të fundit në institucionet më të rëndësishme financiare dëshmojnë për dinamizmin e procesit në të cilin ai është angazhuar.

Me vullnetarizëm, ju keni ndërmarrë përsipër që të udhëhiqni reformat delikate të nevojshme për të konsoliduar demokracinë dhe shtetin e së drejtës në Kosovë, në respekt të plotë të vlerave evropiane. Ju keni sjellë një kontribut personal vendimtar ndaj përpjekjeve që kanë për qëllim që t'u japin vendin e merituar bashkësive të ndryshme që e përbëjnë Kosovën dhe në këtë mënyrë të forconi stabilitetin regjional.

E di për rëndësinë që ka për juve afirmimi i një Kosovë stabile, të prospe-



rueshme dhe në rrugën e Evropës. E njoh po ashtu edhe vullnetin tuaj për të punuar në përforc-imin e lidhjeve miqësore dhe të besueshmërisë në mes të dy shteteve tona.

Franca e përkrah plotësisht Republikën e re të Kosovës dhe jam shumë i kënaqur me bisedën që kam pasur me Kryeministrin tuaj, z. Hashim Thaçi, në 8 qershorin e fundit. E kemi përmendur së bashku atë që vendi juaj e ka bërë tashmë, por gjithashtu edhe progreset që mbesin për t'u përmbushur. Do të gëzohesha t'ju ftoja në një moment, të cilin do të duhet ta përcaktojmë me kujdes së bashku, për të paraqitur takimin tonë si njohjen e kalimit të një etape të re prej shtetit tuaj.

Ju lus që të besoni, Zotëri President, në shprehjen e konsideratës time më të lartë.

Nikolas SARKOZY
Shkëlqesia e Tij
Zotëri Fatmir SEJDIU
President i Republikës së Kosovës
Prishtinë ■

Ombudspersoni të jetë institucion i rëndësishëm për adresimin e kërkesave të qytetarëve



22.06.2009. - Presidenti i Repub-likës së Kosovës, dr.Fatmir Sejdiu ka pritur sot në një takim Ombud-spersonin e Kosovës, z.Sami Kurte-shi, të cilit i ka ofruar mbështetje për punën e tij dhe të institucionit që drejton.

"Do ta keni mbështetjen time mbi baza kushtetuese", i tha Presidenti Sejdiu z.Kurteshi. "Keni një punë delikate dhe shumë të rëndësishme për qytetarët e Republikës së Kosovës. Punë ka shumë dhe mund të arrini rezultate të mira", shtoi ai. Presidenti Sejdiu gjithashtu theksoi se Ombudspersoni nuk duhet të jetë vetëm dekor, por të jetë një institucion i rëndësishëm për adresimin e kërkesave të qytetarëve.

Ndërsa, Ombudspersoni Kurteshi falënderoi Presidentin Sejdiu për mbështetjen morale dhe institucionale. "Kemi një mision të rëndësishëm dhe funksionimi i mirë i institucionit të Ombudspersonit është kusht i domosdoshëm për të krijuar një shoqëri të shëndoshë", tha z.Kurteshi■

Presidenti Sejdiu priti piloten shqiptaro-amerikane Faruza Kallaba



23.06.2009. - Presidenti i Republikës së Kosovës, dr.Fatmir Sejdiu priti sot në një takim piloten shqiptare në ushtrinë amerikane, Faruza Kallaba, e cila mori pjesë në fushatën ajrore të NATO-s për çlirimin e Kosovës, dhjetë vjet më parë. Në takim ishte i pranishëm edhe babai i zonjës Kallaba, Haki Kallaba. ■

Presidenti Sejdiu priti ambasadorin e Japonisë, z. Akio Tanaka



23.06.2009. - "Qytetarët dhe institucionet e Republikës së Kosovës do t'i jenë përherë mirënjohës Japonisë për mbështetjen e rëndësishme që i ka dhënë ajo Kosovës, si në kohën e luftës, ashtu edhe në periudhën e rindërtimit të vendit dhe të forcimit të institucioneve tona demokratike", tha Presidenti i Republikës së Kosovës, dr. Fatmir Sejdiu gjatë një takimi që pati sot me ambasadorin jorezident të Japonisë, z.Akio Tanaka, i cili solli letrat kredenciale të emërimit të tij në këtë detyrë.

Po ashtu, Presidenti Sejdiu ritheksoi përkushtimin e plotë të Republikës së Kosovës për fqinjësi të mirë me të gjitha vendet e rajonit, si dhe për ecje më të shpejtë drejt integrimeve euroatlantike. Ndërsa, ambasadori japonez, pasi theksoi se ndihej tepër i nderuar që do ta përfaqësonte vendin e tij si ambasador i parë në Republikën e Kosovës, tha se Japonia do të vazhdojë ta mbështesë edhe në të ardhmen Republikën e Kosovës në të gjitha fushat. ■

Hamit Bojnik emërohet anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

23.06.2009. - Presidenti i Republikës së Kosovës, dr.Fatmir Sejdiu ka emëruar sot z.Hamit Bojnik anëtar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), në cilësinë e përfaqësuesit të Partisë Demokratike Turke të Kosovës.

Emërimi nga ana e Presidentit të Republikës është bërë duke u bazuar në Nenin 61.3(a) dhe Nenin 62 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe duke pasur parasysh propozimin e Grupit Parlamentar 7+, përkatësisht Partisë Demokratike Turke të Kosovës, që reprezenton komunitetin turk. ■

Presidentët e Shqipërisë, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Kosovës po takohen në Vlorë

"Republika e Kosovës është shtet demokratik i të gjithë qytetarëve të saj të barabartë pa dallim etnie e besimi dhe përcaktim i saj i përhershëm është fqinjësia e mirë dhe marrëdhëniet e ngushta të bashkëpunimit me të gjitha vendet e rajonit", tha Presidenti i Republikës së Kosovës, dr. Fatmir Sejdiu



23.06.2009. - "Republika e Kosovës është shtet demokratik i të gjithë qytetarëve të saj të barabartë pa dallim etnie e besimi dhe përcaktim i saj i përhershëm është fqinjësia e mirë dhe marrëdhëniet e ngushta të bashkëpunimit me të gjitha vendet e rajonit", tha Presidenti i Republikës së Kosovës, dr. Fatmir Sejdiu, gjatë një takimi të përbashkët që pati sot në Vlorë me homologët e tij nga Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia, presidentët Bamir Topi, Filip Vujanović dhe George Ivanov. Këtë qëndrim Presidenti Sejdiu e paraqiti edhe në takimet e veçanta që pati me presidentët Topi, Vujanović dhe Ivanov.

Topi: Lidershipi i Kosovës po tregon maturi dhe pjekuri të admirueshme politike

"Kam vlerësuar vazhdimisht rolin tuaj, rolin e institucioneve dhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës në një vit të Kushtetutës dhe në një vit e gjysmë të pavarësisë së Kosovës", tha Presidenti i Republikës së Shqipërisë, dr. Bamir Topi në takimin që pati me Presidentin Sejdiu.

"Ju po tregoni urtësi, pragmatizëm dhe modernitet në udhëheqje dhe këtë ua them të gjithë burrështetasve që takoj", theksoi Presidenti Topi, duke shtuar se lidershipi i Kosovës po tregon maturi dhe pjekuri të admirueshme politike. Ai takimin e katër presidentëve të rajonit në Vlorë e vlerësoi si shumë të rëndësishëm, meqë është një mesazh i fuqishëm se vendet tona po hyjnë në një etapë të re të bashkëpunimit. Gjithashtu, Presidenti Topi shprehu edhe një herë përkrahjen e tij të parezervë për idenë e Presidentit Sejdiu që Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi të aplikojnë një sistem tërësisht të lirë të qarkullimit të njerëzve dhe të mallrave, duke i liberalizuar kufijtë, si dhe duke i hequr kontrollet e pasaportave

në pikat kufitare.

Sa u përket marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve, Presidenti Topi tha se Shqipëria dhe Kosova do të njohin vetëm forcim të tyre. Rruga Durrës-Prishtinë, sipas tij, do të nxisë edhe më tej thellimin e komunikimit Shqipëri-Kosovë në të gjitha fushat e jetës.

"Kjo rrugë është një dëshmi më vete se sa shumë punë është bërë gjatë këtyre viteve të fundit, se sa ndryshime rrënjësore kanë ndodhur", pohoi Presidenti Topi.

Duke e falënderuar Presidentit Topi për ftesën, Presidenti Sejdiu ritheksoi se Shqipëria ka qenë një mbështetës i plotë i Kosovës në të gjitha proceset. Ai vlerësoi rolin jashtëzakonisht konstruktiv që Presidenti Topi dhe gjithë klasa institucionale dhe politike e Shqipërisë ka patur dhe vazhdon të ketë në zhvillimet e përgjithshme në rajonin tonë.

Ndërsa, duke folur për autostradën Durrës-Prishtinë, Presidenti Sejdiu tha se ajo, pa asnjë dyshim, do t'i shërbejë zhvillimit më të hovshëm ekonomik jo vetëm të Shqipërisë dhe Kosovës, por të gjithë rajonit.

Edhe në këtë takim, Presidenti Sejdiu u angazhua që kjo pjesës e Evropës Juglindore të japë dëshminë e saj të fuqishme se tashmë është e gatshme për të ecur edhe më hovshëm drejt integrimeve euroatlantike, duke e liberalizuar lëvizjen e qytetarëve të saj, duke e shtuar nivelin e bashkëpunimit ekonomik dhe duke e thelluar edhe më shumë shkëmbimin tregtar.

Kosova dhe Maqedonia kanë shumë pika të përbashkëta

Presidenti i Republikës së Kosovës, dr. Fatmir Sejdiu idenë e liberalizimit të lëvizjes së qytetarëve, si dhe të heqjes së plotë të pasaportave në një të ardhme sa më të afërt ia shtroi edhe homologut të tij nga Maqedonia, z. George Ivanov.

"Ne kemi shumë pika të përbashkëta, që lidhen me historinë tonë, por edhe me ambiciet tona për integrimet në Bashkimin Evropian, në NATO dhe në mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë", tha Presidenti Sejdiu gjatë takimit me Presidentin Ivanov.

Për ne, vijoi Presidenti Sejdiu, është me rëndësi të demonstrojmë gatishmërinë tonë, si rajon, se jemi të përkushtuar për bashkëpunim dhe për marrëdhënie të mira. Gjithashtu, krahas liberalizimit të kufijve, Presidenti Sejdiu shtroi domosdonë e shtimit të bashkëpunimit rajonal për pengimin dhe luftimin e dukurive të këqija që mund të paraqiten në vendet tona, veçmas të atyre dukurive që janë të karakterit të krimit të organizuar.

"Republika e Kosovës gjithmonë e ka trajtuar dhe do të vazhdojë ta trajtojë Maqedoninë si partner strategjik", tha Presidenti Sejdiu.

Po në këtë frymë, Presidenti Ivanov pohoi se vendi i tij është i vendosur për ta thelluar bashkëpunimin me Republikën e Kosovës.

"Besojmë se dy qeveritë tona do të bëjnë punën e duhur që përfundimisht të zgjidhet edhe çështja e kufirit, në mënyrë që të ecet përpara drejt vendosjes së plotë të marrëdhënieve bilaterale, të cilat janë në interes të ndërsjellë", tha Presidenti Ivanov.

Presidenti Sejdiu dhe Presidenti Ivanov pohuan se është me rëndësi jetike për dy vendet që keqkuptimet e kohëve të fundit në relacionet zyrtare mes Shkupit dhe Prishtinës të tejkalohen, ndërsa që i gjithë rajoni të përqendrohet në arritjen sa më të shpejtë të synimeve të përbashkëta për integrimet euroatlantike.

Vujanović: Mali i Zi përshëndet përpjekjet e Kosovës për paqe dhe stabilitet në rajon

Edhe në takimin me Presidentin e Republikës së Malit të Zi, z. Filip Vujanović, Presidenti Sejdiu theksoi përkushtimin e institucioneve dhe të qyte-

tarëve të Kosovës për të qenë shembull i bashkëpunimit, madje jo vetëm me Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë, por edhe me të gjitha vendet e tjera të rajonit.



"Përvoja e Malit të Zi në procesin e tranzicionit dhe të ndërtimit të institucioneve demokratike është një model i mirë edhe për vendet e tjera", tha Presidenti Sejdiu, duke pohuar vullnetin e plotë të Prishtinës zyrtare për ruajtjen dhe forcimin e frymës së miqësisë dhe të fqinjësisë së mirë në mes të të dyja vendeve.

"Ne duam që të kemi marrëdhënie të mira edhe me Serbinë, ashtu siç i kemi me të gjitha vendet e tjera, por insistojmë që Beogradi të heqë dorë nga politika e shkaktimit të tensioneve në vendet fqinje", theksoi Presidenti Sejdiu, duke shtuar se investimet e Beogradit për t'i mbajtur gjallë dhe për t'i financuar strukturat paralele, sidomos në veri të Kosovës, janë shumë të dëmshme dhe rrezikojnë të ardhmen e të gjithëve, si të shumicës shqiptare, ashtu edhe të komuniteteve pakicë.

Sa u përket marrëdhënieve me Malin e Zi, Presidenti Sejdiu vlerësoi se ato janë shumë të mira dhe me kohë do të njohin zhvillime edhe më pozitive.

Ndërkaq, Presidenti malazez, z. Filip Vujanović tha se Mali i Zi dhe Kosova do të bashkëpunojnë edhe më tej si dy vende të pavarura.

"Mali i Zi është vend mik i Kosovës, ndërsa populli malazez është mik me popullin e Kosovës!", theksoi Presidenti Vujanović, duke shprehur mirënjohjen e tij për angazhimet e gjithanshme të institucioneve të Kosovës për ta përmirësuar standardin jetësor të qytetarëve të vendit, për ta shtuar shkallën e sigurisë dhe të bashkëpunimit në rajon.

Në këtë takim, ai kërkoi që institucionet e Kosovës ta shqyrtojnë tretmanin e malazezve në Republikën e Kosovës, si dhe çështjen e kthimit të personave të zhvendosur nga Kosova, të cilët aktualisht janë duke jetuar në Malin e Zi.

Duke iu përgjigjur interesimit të Presidentit Vujanović, Presidenti Sejdiu tha se ai tashmë ka angazhuar në Këshillin Konsultativ për Komunitete përfaqësuesin e malazezve të Kosovës, në mënyrë që ta ndihmojë drejtpërdrejt avancimin e mëtejmë të pozitës së tyre, kurse sa u përket të zhvendosurve ai ritheksoi se është zotim i institucioneve të Republikës së Kosovës që të gjithë qytetarët e saj, pa dallim etnie, do ta kenë mundësinë për t'u kthyer dhe për të jetuar në atdheun e vet, në Kosovë.

Nesër, të katër presidentët do të kenë një takim tjetër të përbashkët. Fill pas tij, ata do të dalin në një konferencë të përbashkët me gazetarë. Në orët e pasdites, Presidenti Sejdiu do të takohet në Tiranë me Kryeministrin e Shqipërisë, z. Sali Berisha. ..... ■

Presidentët Sejdiu, Topi, Ivanov e Vujanoviq mbajnë konferencë shtypi në përmbyllje të takimit

"Kosova është një vend i ri, i njohur nga 60 vende të botës. Unë shpreha konsideratën për njohjet që kanë bërë edhe vendet fqinje, dhe sigurisht se kjo është një kaptinë e re e zhvillimit të raporteve edhe ndërshtetërore që duhet të jetë me kualitetin e vet dhe për këtë arsye pikërisht këto veprime që janë bërë të mira të deritashme, janë kontribut për të ardhmen, gjithë ajo që ka mund me qenë nganjëherë sekuencë jo e përshtatshme për zhvillimet historike", ka theksuar Presidenti Sejdiu.

4.06.2009. - Presidenti i Republikë së Kosovës, dr. Fatmir Sejdiu, Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi, Presidenti i Malit të Zi, Filip Vujanoviq dhe Presidenti i Maqedonisë, Gjorgje Ivanov kanë mbajtur një konferencë të përbashkët për media, në përfundim të takimit dyditor të mbajtur në Vlorë. Pasi ka lavdëruar iniciativën e Presidentit Topi për organizimin e këtij takimi shumë të rëndësishëm, Presidenti Sejdiu është shprehur se në takim të katër presidentët kanë pasur mundësi të jashtëzakonshme të komunikimeve më të mira të mundshme mes vete.

"Kosova është një vend i ri, i njohur nga 60 vende të botës. Unë shpreha konsideratën për njohjet që kanë bërë edhe vendet fqinje, dhe sigurisht se kjo është një kaptinë e re e zhvillimit të raporteve edhe ndërshtetërore që duhet të jetë me kualitetin e vet dhe për këtë arsye pikërisht këto veprime që janë bërë të mira të derita-shme, janë kontr-ibut për të ardhmen, gjithë ajo që ka mund me qenë nganjëherë sekuencë jo e përshtatshme për zhvillimet historike", ka theksuar Presidenti Sejdiu.



Ai ka theksuar se takimet e këtij lloji "janë pika të rëndësishme të zhvillimeve historike që bashkojnë popujt tanë, vendet tona, janë kapërcime të fateve gati identike në sit-

uata herë-herë shumë të vështira, janë relacione praktike të ndërtuara të mira. Qytetarët tanë lëvizin, ecin, shtetet tona janë shtete që kanë njohur njëra tjetrën".

"Janë vizion i përbashkët për ecje të proceseve të mëparshme në proceset integruese euroatlantike. I kemi miqtë e përbashkët, kjo është sublimim i ndjenjës së përgjithshme që kemi, për ne është borxh i veçantë që të japim, të realizojmë pritjet e qytetarëve tanë, dhe ato janë pikërisht në pjesën praktike në shpejtime praktike për një jetë më të mirë për të gjithë qytetarët, në bashkëpunimet ekonomike, veçanërisht në bashkëpunimet kulturale të fushave të shumta dhe të dijes, në atë që do ta quaja të konkurrencës sportive, pse jo dhe të shkëmbimit të përvojave më të mira të mundshme në arritjet e deritashme", vijoi Presidenti Sejdiu.

"Ne e vlerësojmë lart anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në NATO dhe shprehjen e kandidaturës për të qenë në Bashkimin Evropian, vlerësojmë lart arritjet e Malit të Zi dhe të Maqedonisë po kështu në pjesën e kritereve të rëndësishme për proceset integruese dhe po ashtu vlerësuam bashkë këtë gatishmëri që të lëvizim më shpejt në këto procese", tha ai.

Është e vërtetë se ka paralajmërime për vështirësitë e integrimeve në Bashkimin Evropian por është e vërtetë po ashtu se ka lëvizje shumë pozitive pikërisht edhe të vendeve tona që të jemi një ditë shumë shpejt atje. Është shumë pozitive, se shumë nga vendet e rajonit janë atje dhe, deshëm a s'deshëm, rajoni s'mund të mbetet i paplotësuar edhe me hartën e plotë të procesit integrues, theksoi ai.

"Jemi në kohë të re, jemi në kohë për kontribute të përbashkëta, për paqen dhe stabilitetin, jemi në kohë të vullnetit të mirë dhe të punës të mbarë që bëhet", tha Presidenti Sejdiu.

Duke folur në cilësinë e nikoqirit, Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi ka theksuar se në kuadër të frymës së integrimit euro-atlantike, ne dëshirojmë që në plan të parë të kemi lëvizjen e lirë të qytetarëve në vendet tona, të biznesit dhe të gjitha aktivitetet tjera.

"Ne së bashku trajtuam tema shumë të rëndësishme që kanë të bëjnë me situatën aktuale në vendet tona. Me situatën e re mjaft pozitive që kalon rajoni i Ballkanit Perëndimor. Me aspiratën e përbashkët euro-atlantike të vendeve tona, me nevojën e thellimit të dialogut politik midis nesh, me evidentimin e një situate të re gjeopolitike në rajon. Mbas dialogut mjaft të mirë politik, del nevoja e intensifikimit të bashkëpunimit ekonomik, mes vendeve tona", tha z.Topi duke folur për takimin e katër presidentëve. Nga terminologjia e përgjithshme, ne po realizojmë projekte konkrete, theksoi Presidenti Topi, duke shtuar se ka ardhur koha e një diplomacie të re në rajon, "një përmirësim i ndjeshëm i infrastrukturës, një sinkronizim i interesave të vendeve tona për të punuar për një sistem të përbashkët energjik në rajon, një rritje e turizmit reciprok".

Pasi ka përkujtuar se Shqipëria u jep akces të gjitha vendeve të rajonit në portet e saj të rëndësishme, z.Topi ka theksuar se në takim është diskutuar edhe për krijimin e klimës pozitive për të gjithë investitorët që duan të vijnë në rajon.

Unë shpreh dëshirën që ky takim të pasohet me takime të tjera, ku secili nga miqtë në vendin e vet do të bëhet mikpritësi, tha ai.

Ndërsa Presidenti i Maqedonisë, Gjorgje Ivanov tha se takimi ishte një mundësi e mirë për të shkëmbyer mendimet rreth perspektivës së bashkëpunimit në rajon.

Së bashku me Presidentin Topi, Presidentin Sejdiu dhe Presidentin Vujanoviq konstatuam se një nga qëllimet tona të përbashkëta është anëtarësimi i vendeve tona në NATO-s, ku Shqipëria është anëtarësuar, tha ai.

Duke u nisur nga synimet e përbashkëta për integrime euro-atlantike, Presi-

denti Ivanov tha se kjo tregon se pas një kohe rajoni po vendos parimet dhe vlerat e njëjta. "Rajoni tashmë po dërgon mesazh pozitiv jashtë tij. Ajo që ishte e paimagjinueshme për prindërit tanë, tani realizohet për brezat e ardhshëm, për të jetuar në një botë më të mirë", tha ai, duke shtuar se komunikimi ynë është një sinjal se kemi tejkaluar pengesat që kanë ekzistuar në të kaluarën në komunikim.

"Konstatuam se qëllimet tona strategjike janë integrimi euro-atlantik dhe që të gjitha vendet, në kuadër të shteteve të tyre, të arrijnë sukses në këtë qëllim. Gjithashtu, shfaqëm vendosmërinë që të shkëmbejmë përvojat tona, në këtë rrugë. Theksuam se nuk ka Evropë të bashkuar pa shtetet e Ballkanit Perë-ndimor, se qëllimi ynë strategjik është Bashkimi Evropian, por edhe ky union do të jetë i plotë kur Ballkani Perëndimor të jetë në të", theksoi Presidenti i Malit të Zi, Filip Vujanoviç.

Ai theksoi se marrëdhëniet me Shqipërinë dhe Maqedoninë janë shumë të mira dhe se nuk ka çështje të hapura, sikur që edhe komunikimi është në nivelin më të mirë.

Vujanoviq tha se me Presidentin e Kosovës, z.Fatmir Sejdiu, ka biseduar për marrëdhëniet mes dy vendeve, pas njohjes së pavarësisë së Republikës së Kosovës nga Mali i Zi, duke përmendur në këtë rast një varg takimesh bilaterale.

Ai tha gjithashtu se ekzistojnë dy çështje të hapura mes të dy shteteve, të cilat beson se do të zgjidhen shumë shpejt. Sipas tij, çështja e parë është trajtimi i pakicës malazeze në Kosovë, ndërsa çështja e dytë ka të bëjë me kthimin e personave të shpërngulur nga Kosova që aktualisht ndodhen në Mal të Zi dhe të cilat, tha ai, kanë shprehur dëshirën që të kthehen në Kosovë.

Dy çështjeve të ngritura nga Presidenti Vujanoviq i është përgjigjur Presidenti Sejdiu. "Unë vërtetë çmoj gjithë bisedat që ne kemi bërë dhe gatishmërinë që të zhvillojmë procese të mira në favor të vendeve tona dhe natyrisht edhe për këto dy çështje kemi biseduar me Presidentin Vujanoviq", tha ai

E para, sa i përket procesit të kthimit të qytetarëve të Kosovës, Kosova ka pasur një fat të keq që shumë qytetarë kanë pësuar brenda dhe ka pasur edhe një kategori të qytetarëve që kanë lëshuar vendin për arsye të rrethanave të vështira të luftës dhe shumë të tjerë kanë pësuar vetë, janë vrarë, janë masakruar, tha Presidenti Sejdiu.

"E thash edhe sot në takimin e përbashkët plenar, nuk ia dëshirojmë këtë fat askujt dhe natyrisht se kemi qëndrim parimor për kthimin e gjithë qytetarëve të Kosovës. Ka vështirësi objektive, Qeveria e Kosovës ka ndarë fonde të veçanta për këtë dhe ka progres dhe Ministria e Kthimit merret drejtpërdrejt me këtë dhe udhëhiqet nga një përfaqësues i komunitetit serb. Pra s'kemi dilemë, dilema mund të kenë vetëm njerëzit që kanë bërë veprime të këqija në Kosovë dhe u pajtuam edhe me Presidentin Vujanoviq se ata duhet të dalin para drejtësisë", vijoi ai.

Ndërsa duke folur për komunitetin malazez, Presidenti Sejdiu tha se në Kosovë ka një prezencë të këtij komuniteti dhe institucionet e Kosovës japin të gjitha garancitë e mundshme në trajtimin e tyre si çdo qytetar i Kosovës.

"Unë kam bërë një hap të rëndësishëm, jashtë vizionit të Projektit Ahtisari, në Këshillin Konsultativ të Komuniteteve kam inkuadruar përfaqësuesin malazez. Ky këshill është një trup shumë i rëndësishëm, që adreson interesat, shqetësimet e qytetarëve dhe natyrisht kemi një komunikim të shkëlqyeshëm", tha ai.

Presidenti Sejdiu, por edhe Presidenti Ivanov e ai Vujanoviq, duke u përgjigjur në pyetjet e gazetarëve, kanë theksuar se marrëdhëniet mes vendeve janë shumë të mira, ndërsa që është në proces edhe vendosja e marrëdhënieve diplomatike, si dhe i një varg veprimesh që do të rrisin edhe më tej shkallën e bashkëpunimit në të gjitha fushat. ■

Rruga Durrës-Kukës-Morinë një korridor jashtëzakonisht i rëndësishëm

Presidenti Sejdiu dhe kryeministri Berisha e cilësuan rrugën Durrës-Kukës-Morinë një korridor jashtëzakonisht të rëndësishëm si një urë lidhëse që do të nxisë lëvizjen dhe shkëmbimet jo vetëm ndërmjet dy vendeve, por edhe në rajon.

24 qershor 2009 - Presidenti i Republikës së Kosovës, dr. Fatmir Sejdiu u prit nga kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha, me të cilin diskutuan për zhvillimet e përgjithshme në mes të dy vendeve dhe vlerësuan se pavarësia ka prodhuar paqe dhe stabilitet.
Presidenti Sejdiu dhe kryeministri Berisha e cilësuan rrugën Durrës-Kukës-Morinë një korridor jashtëzakonisht të rëndësishëm si një urë lidhëse që do të nxisë lëvizjen dhe shkëmbimet jo vetëm ndërmjet dy vendeve, por edhe në rajon.
Gjithashtu, Presidenti Sejdiu dhe Kryeministri Berisha shkëmbyen mendime për thellimin e bashkëpunimit të gjithanshëm mes dy vendeve, duke u ndalur në mënyrë të veçantë në fushën ekonomike.
Kryeministri Berisha e informoi Presidentin Sejdiu se para pak ditësh e ka inauguruar edhe rrugën Has-Qafë Prush, që do të ketë gjithashtu një ndikim pozitiv në lehtësimin e lëvizjes mes dy vendeve.
Presidenti Sejdiu i shprehu Kryeministrit Berisha vlerësimet dhe konsideratën e tij më të lartë për reformat e suksesshme të ndërmarra nga qeveria shqiptare dhe progresin që Shqipëria ka bërë gjatë këtyre viteve me anëtarësimin e vendit në NATO, në infrastrukturë, në fushën ekonomike etj. ■



Lituania e përkushtuar për të ndihmuar Republikën e Kosovës

"Është kohë e ndryshimeve, kohë e shtigjeve të reja për zhvillimin e Kosovës, kohë e shtigjeve të reja në marrëdhëniet tona bilaterale, jo vetëm në fushën ushtarake, por edhe në fushën ushtarake dhe atë ekonomike", theksoi Rasa Jukneviciene.



25.06.2009. - Presidenti i Republikës së Kosovës, dr. Fatmir Sejdiu prit sot në takim ministren e Mbrojtjes të Lituanisë, Rasa Jukneviciene, me të cilën ka biseduar për bashkëpunimin midis dy shteteve dhe mbështetjen që Lituania u ka dhënë proceseve në vendin tonë.

"Me ministren Rasa Jukneviciene biseduam për shumë procese që kemi kapërcyer, një bashkëpunim dhe mbështetje që i është dhënë Kosovës, një shprehje të falënderimit të veçantë për njohjen që i është bërë Republikës së Kosovës nga vendet e para, në një falënderim për investime të rëndësishme me njerëz, me ngritjen e potencialeve të demokracisë por edhe të sigurisë në Kosovë sidomos me pjesëmarrjen e një kontingjenti të tyre dhe me përkushtimin që do të kenë në mbështetje të mëtejshme të Kosovës veçanërisht në përmbushje të kritereve të lëvizjeve tona drejt proceseve të integrimeve euroatlantike", theksoi Presidenti Sejdiu.

U pajtuam se kemi shumë pika të përbashkëta të historive tona si dy vende, u pajtuam po ashtu se më e mira është që të vazhdohet pikërisht me refleksionet e zhvillimeve të brendshme të mira dhe të asaj që mund të quhet kontribut dhe partneritet për paqe dhe stabilitet. U pajtuam njëkohësisht që do të ketë shumë fusha në të cilat do të mund të bashkëpunojmë sidomos ato që kanë të bëjnë me aspekte të komunikimeve ekonomike dhe pjesë të tjera të rëndësishme për jetën e qytetarëve, tha Sejdiu.

Presidenti Sejdiu ka theksuar se kontingjenti i trupave të Lituanisë në kuadër të KFOR-i ka bërë punë shumë të mirë dhe ka theksuar se ata do të ndihmojnë edhe Kosovën, duke qenë pjesë e strukturave të përgatitjes së mëtejme të Forcës së Sigurisë së Kosovës në profesionalizimin e saj.

Ministrja e Mbrojtjes e Lituanisë, Rasa Jukneviciene, pasi shprehu kënaqësinë që ndodhej në Kosovë, shprehu bindjen e saj se puna e trupave të tyre si kontingjent i përbashkët me trupat e Polonisë dhe të Ukrainës, ka qenë shumë e suksesshme dhe se prania e tyre do të vazhdojë nëpër qendrat e trajnimeve.

"Është kohë e ndryshimeve, kohë e shtigjeve të reja për zhvillimin e Kosovës,

kohë e shtigjeve të reja në marrëdhëniet tona bilaterale, jo vetëm në fushën ushtarake, por edhe në fushën ushtarake dhe atë ekonomike", theksoi Rasa Jukneviciene.
Gjithashtu, ajo duke u angazhua për zhvillimin e avancimin e mëtejshëm të marrëdhënieve tha që pret nga Parlamenti i Kosovës që të krijojë grup të veçantë për marrëdhënie me Parlamentin e Lituanisë.
Presidenti Sejdiu është pyetur pas takimit nga gazetarët edhe lidhur me arrestimin nga autoritetet bullgare të ish-kryeministrit të Republikës së Kosovës, Agim Çeku.
"Interpoli nuk mund të veprojë dhe s'duhet të veprojë në bazë të fletarresteve të një vendi tjetër, i cili realisht nuk ka juridiksion ndaj njerëzve të Kosovës. Pra, për ne është me rëndësi që të përcjellim mesazhet tona dhe kërkesat tona dhe ato janë bërë dhe është paralele edhe çështja e bashkëpunimit në këtë partneritet sigurie. Edhe policia e Kosovës do të jetë faktor i rëndësishëm në bashkëpunim me degë të Interpolit dhe besoj se do të zhvillohet edhe te Europol, edhe njësia e veçantë e bashkëpunimit me Prishtinën", tha Presidenti Sejdiu.
Pasi ka përkujtuar se Serbia ka lëshuar fletarreste për të gjithë udhëheqësit shtetërorë të Kosovës, Presidenti Sejdiu theksoi se Serbia po mundohet në çdo formë të kompromet ojë ecjen tonë, por nuk do ta arrijë këtë. "Ju them se nuk do të arrijë, por do të kemi nevojë për një bashkëpunim edhe me vendet veç e veç që të kenë kujdes", tha ai.
"E keni parë se nëse s'ju shkon në një front pengimi i njohjeve të mëtejshme të Republikës së Kosovës, në atë ofensivën që e ka marrë republika dhe qeveria serbe, Jeremiqi dhe të gjithë tjerët, atëherë shfrytëzojnë edhe diçka tjetër për të bërë probleme", theksoi Presidenti Sejdiu.
Ne nuk jemi në ato politika, do të jemi dhe do të vazhdojmë në politikat e mira të bashkëpunimit me gjithë vendet dhe natyrisht të reflektojmë atë që e kemi pasur kurs dhe busullë themelore tonën në refleksionet më të mira pozitive, në raport edhe me shtetet fqinje. Prandaj nuk do të mund të pengojë Serbia, ajo do të bëjë përpjekje por s'do të mundet ta arrijë këtë", tha Sejdiu. ■

Presidenti Sejdiu priti poetin Visar Zhiti



26.06.2009. - Presidenti i Republikës së Kosovës, dr. Fatmir Sejdiu priti sot poetin Visar Zhiti, laureat i sivjetshëm i çmimit letrar "Beqir Musliu", i cili jepet në Gjilan për arritje të mëdha në fushën e letërsisë.
Krijimet e Visar Zhitit, qoftë në prozë, qoftë në poezi janë përkthyer në shumë gjuhë të botës, si dhe janë përfshirë në shumë antologji. Po ashtu, Zhiti është fitues i shumë çmimeve ndërkombëtare. ■

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese zotohen se do ta kryejnë punën me nder

Duke vlerësuar përzgjedhjen e gjyqtarëve të përzgjedhur nga Parlamenti i Republikës së Kosovës si dhe gjyqtarëve ndërkombëtar nga ana e ICO-s, Presidenti Sejdiu shprehu bindjen dhe besimin e tij në punën, energjinë dhe dijen e të gjithë gjyqtarëve të përzgjedhur.



26.06.2009. - Sot, në një ceremoni të veçantë të organizuar në Presidencë para Presidentit të Republikës së Kosovës, dr. Fatmir Sejdiu, dhanë betimin Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Në ceremoni ishin të pranishëm kryetari i Parlamentit Jakup Krasniqi, Kryeministri Hashim Thaçi, shefi i Zyrës Civile Ndërkombëtare (ICO), Peter Feith, shefi i EULEX-it, Iv de Kermabon, si dhe përfaqësues të ambasadave të vendeve të Kuintit të akreditуar në vendin tonë.

Presidenti Sejdiu tha se Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës është një institucion me peshë të veçantë për Kosovën, për qytetarët e vendit. Ai tha se me Gjykatën Kushtetuese po përmbyllet një cikël i rëndësishëm i rrugëtimit të Kosovës në ndërtimin e institucioneve më vitale.

Duke vlerësuar përzgjedhjen e gjyqtarëve të përzgjedhur nga Parlamenti i Republikës së Kosovës si dhe gjyqtarëve ndërkombëtar nga ana e ICO-s, Presidenti Sejdiu shprehu bindjen dhe besimin e tij në punën, energjinë dhe dijen e të gjithë gjyqtarëve të përzgjedhur.

"Ata do jenë në shërbim të Kosovës në shërbim të qytetarëve dhe në shërbim të drejtësisë dhe respektimi i aktit më të lartë juridik të vendit do të jetë parimor dhe i paanshëm. Ato do të jenë busullë e rëndësishëm e veprimit dhe e zhvillimit kushtetues të Kosovës", theksoi Presidenti Sejdiu.

Ndërsa, shefi i Zyrës Civile Ndërkombëtare, z. Feith foli për rëndësinë e kompletimit të tablosë institucionale të Kosovës dhe i përgëzoi gjyqtarët e përzgjedhur për emërimin e tyre.

"Sot shënojmë inaugurimin e shtyllës së fundit të tablosë institucionale të Kosovës. Në dhënien e betimit për këtë post gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës zotohen të jenë interpretuesit e paanshëm dhe mbrojtësit e kësaj Kushtetute" tha ai.

Më tej z. Feith foli për certifikim e Kushtetutës së Republikës së Kosovës të bërë nga ai në prill të vitit të kaluar në përputhje me Propozimin Gjithëpërfshirës të Presidentit Ahtisaari. Ai gjithashtu theksoi se Kushtetuta e Kosovës, në të vërtet është një dokument

i përpiluar me mjeshtri dhe bukuri dhe paraqet aspiratën e qytetarëve të Kosovës që të jetojnë në një atdhe të lirë, demokratik dhe shumetnik e po ashtu të respektuar nga bota, dhe i falënderoi të gjithë ata që kanë kontribuar në hartimin dhe miratimin e saj.
Duke shprehur shpresën e tij se gjyqtarët do të kryejnë detyrat e tyre duke qenë plotësisht të vetëdijshëm për besimin që qytetarët e Kosovës kanë në ta, ai citoi thënien e Sokratit se gjyqtarit i takojnë katër gjëra: "Të dëgjojë me mirësjellje, të përgjigjet me urtësi, të shqyrtojë me kthjelltësi dhe të vendos në mënyrë të paanshme".
Pas fjalës së përfaqësuesit të Zyrës Civile Ndërkombëtare në Kosovë, z. Feith, një fjalë të shkurtër mbajti edhe Kryetari i Parlamentit të Kosovës, z. Jakup Krasniqi, për të pasuar ceremonia e dhënies së betimit veç e veç nga gjykatësit e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.
Në tekstin e betimit të Gjykatësve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës thuhet:
"Betohem solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës së gjyqtaritë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, do t'i qëndrojë besnik Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe do të ushtrojë funksionin e gjyqtarit me nder, përgjegjësi duke i respektuar rregullat e etikës profesionale. Betohem"! ■

Sejdiu priti komandantin e KFOR-it, gjeneralin Gay dhe pasardhësin e tij, gjeneralin Bentler

26.06.2009. - "Puna profesionale dhe angazhimi i jashtëzakonshëm i të gjithë komandantëve dhe ushtarëve të KFOR-it, si dhe përkushtimi i institucioneve dhe qytetarëve të Kosovës kanë bërë që sot në vendin tonë të kemi paqe, qetësi dhe stabilitet të përgjithshëm", tha Presidenti i Republikës së Kosovës, dr. Fatmir Sejdiu gjatë një takimi që pati sot me komandantin e KFOR-it, gjeneralin italian Giuseppe Emilio Gay, i cili shoqërohej edhe nga pasardhësi i tij në këtë detyrë, gjenerali gjerman Markus Bentler.
Presidenti Sejdiu pohoi se KFOR-i është një faktor shumë i rëndësishëm i paqes, stabilitetit dhe sigurisë jo vetëm në Kosovë, por në tërë rajonin. Me këtë rast, ai e vlerësoi lart punën e suksesshme të gjeneralit Gay si komandant i KFOR-it. Ndërsa, gjeneralit Bentler Presidenti i shfaqi urimet më të mira për besimin e dhënë që të komandojë forcat e paqes në Kosovë, duke i garantuar përkushtimin e plotë të institucioneve të vendit për bashkëpunim të mëtejshëm
Ndërkaq, gjenerali Gay tha se KFOR-i i ka të gjitha kapacitet e nevojshme për të siguruar një ambient paqësor, të qetë dhe të sigurt në Kosovë edhe pas reduktimit të trupave në terren. Ai shfaqi besimin e plotë se pasardhësi i tij në këtë detyrë, gjenerali Bentler do ta drejtojë me sukses KFOR-in në procesin e tranzicionit, përkatësisht të reduktimit numerik të kësaj trupe shumëkombëshe.
Nga ana e tij, gjenerali Bentler e quajti një mirënjohje dhe nder të veçantë besimin që i është dhënë për t'u prirë forcave të KFOR-it, të cilat, siç tha ai, pavarësisht numrit, janë dhe do të jenë në gjendje në çdo kohë të sigurojnë paqen për të gjithë në Kosovë.
Gjithashtu, në këtë takim u çmua puna e mirë që po bëhet për formësimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe roli tepër i rëndësishëm që kanë në këtë mision ekspertët e NATO-s. ■